




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Ne bazë të nenit 46 të Kushtetutës së Kosovës, nenit 14, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 dhe në përputhje me nenin 6 dhe 10 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të Komunës, Rregullores së QRK-së Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Palujtëshme të Komunës, Ligjit mbi energjinë nr.03/L-184, nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, duke vendosur sipas kërkesë së Drejtoris për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinorë të dt.21.03.2018, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.03.2018, bie këtë:

VENDIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99) VITE TË TOKËS KOMUNALE

I.

I ipet në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të tokës në pronësinë komunale pa kompensim material, përvës Tatimit në pronë, Kompanisë KEDS-sh.a, Divizioni i Shpërndarjes, një pjesë e ngastrës kadastrale nr.2523-0, nga certifikata: P-70511038-02523-0, me sipërfaqe (2x2) m, Zona Kadastrale Isniq.

II.

Në ngastrën e cekur më lartë me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite pa kompensim parashihet ndërtimi i një Trafostacioni të Ri 10(20)/0.4v, me qëllim të përfitimit publik.

III.

Me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të një pjese të ngastrës nr.893, marrësi i tokës në shfrytëzim duhet t'i përmbahet Planit Urbanistik.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi dhe për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoria për MSH dhe SHP, sipas të gjitha Ligjeve në fuqi.

V.

Ky vendim miratohet në Kuvend me dt.30.03.2018, ndërsa implementimi i tij kushtëzohet me nënshkrimin e Kontratës në mes të Komunës së Deçanit dhe Kompanisë KEDS-sh.a. si bashk investues në zhvillimin e projekteve të premtuara në sektorin e energjisë me interes për qytetarin.

VI.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

VII.

Me nga një kopje të Vendimit do të paisen: Drejtoritë kompetente Komunale, Arkivi Komunal dhe Kompania KEDS-sh.a.

01.Nr.III-6

Deçan,dt.30.03.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit

Haki Shehaj

HYRJE-KUVENDA-INGOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DECANI MUNICIPALITY	
Nga:	Nr. Prot: 10292
Od:	Gr. Prot:
From:	Prot. No:
Nr. i faqeve:	Data: 06-04-18
Br. Stranica:	Datum: / / 20
No. Pages:	
DEÇAN DECANI	